



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1809/13 Prot.

Pogradec, më 25 . 04 . 2024

VENDIM

NR. 49 , DATË 24 . 04 . 2024

PËR

"DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT "POGRADECI" SH.A. ME NIPT: M03707601D NË MASËN 100%".

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "**Koncepti i autonomisë vendore**" dhe nenit 4 "**Rëndësia e autonomisë vendore**" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 të nenit 9, shkronja "c", shkronjës "e" të nenit 54, shkronjës "i" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenet 120 e ne vijim, neni 135 dhe neni 228 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; neni 113, neni 144 të Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë"; shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 4 të Ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar, Ligjit Nr.9879, datë 21.2.2008, "Për titujt", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Të shfuqizohet Vendimi i Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 16, datë 18.02.2022, "Për themelimin e shoqatës sportive jofitimprurëse "Klubi i Futbollit Pogradeci", dhe miratimin e aktit të themelimit dhe statutit".
2. Të jape pëlqimin për fillimin e procedurës për shpalljen për shitje të 100 % të aksioneve që Bashkia Pogradec zotëron si aksionere e vetme në Shoqërinë, Klubi i Futbollit Pogradeci Sha, me NUIS (NIPT): M03707601D.
3. Çmimi minimal i shitjes së 100 % të kuotave të përcaktohet pasi bëhej një analizë financiare e përditesuar nga viti 2021 në viti 2024, nga ana e Ekspertit Kontabël (Audituesit Ligjorë të Emëruar).



4. Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Pogradec në Shoqërinë Klubi i Futbollit Pogradeci Sha, të bëhet sipas procedurës konkurruese: Procedurë e Hapur, Standard e Ankandit, sipas dokumentave standarte tip të ankandit, bashkëngjitur këtij vendimi, shtojca 1.
5. Miratimi i kushteve të veçanta të kontratës së shitjes sipas shtojcës 2, bashkëngjitur.
6. Procedura e ankandit për shitjen e 100 % të aksioneve, që zotëron Bashkia Pogradec, të nisë me vlerën që do të përcaktojë analizë financiare e përditësuar nga viti 2021 në viti 2024, nga ana e Ekspertit Kontabël (Audituesit Ligjorë të Emëruar).
7. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 37, datë 28.03.2024, "Për dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurës për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit "Pogradeci" Sh.a me NIPT: M03707601D në masën 100%", shfuqizohet.
8. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë, administrata e Bashkisë Pogradec dhe organet e shoqërisë POGRADECI F.K Sh.a.
9. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 21 vota

2. Vota Pro 21

3. Vota Kundër 1

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 25.04.2024